



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

**Kodi i lëndës: INF 170**

**Lënda: Zhvillimi pediatrik, human dhe social**

PROGRAMI I LËNDËS Zhvillim pediatrik, human dhe social									
<b>Titullari i lëndës:</b>		<b>Aurela Saliaj</b> Prof. Asoc. Phd në Pediatri _____							
<b>Ngarkesa:</b>	Kredite	Orë mësimi në auditor						Studim individual	Totali
		Leksion	Seminar	Labs	Praktikë	Projekte	Total		
	6 ECTS	45	15	0	0	0	60	90	150
<b>Tipologjia e lëndës</b>		Lëndë bazë							
<b>Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda</b>		Viti I, Semestri II							
<b>Lloji i lëndës</b>		E detyruar							
<b>Programi i studimit</b>		Bachelor në "Infermieri të përgjithshme"							
<b>Kodi i lëndës</b>		INF 170							
<b>Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës</b>		<a href="mailto:aurela.saliaj@univlora.edu.al">aurela.saliaj@univlora.edu.al</a>							

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT**

<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Kjo disiplinë është e ndarë në tre pjesë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Etika dhe deontologjia infermiere: në këtë pjesë do të marrin njohuri mbi tërësinë e normave morale që karakterizojnë sjelljen e infermierit gjatë ushtrimit të profesionit. Në pjesën e deontologjisë infermiere do të studiojnë tërësinë e normave nga pikëpamja juridike, të cilat rregullojnë mirë ushtrimin e profesionit të infermierit.</li><li>- Psikologjia mjekësore është e ndarë në dy pjesë: pjesa e parë jep njohuri të përgjithshme mbi teoritë psikologjike, të cilat studiojnë sjelljet njerëzore dhe proceset kognitive. Në pjesën e psikologjisë klinike trajtohen diagnozat infermiere bazë që vendosen në rastet e problemeve psikologjike të pacientëve të hospitalizuar.</li><li>- Pediatria e zhvillimit: ka për qëllim marrjen e njohurive mbi trajtimin e ecurisë dhe ndjekjen e fëmijës nga konceptimi e deri në moshën e adultit. Lënda u jep studentëve njohuritë e nevojshme për të vlerësuar zhvillimin fizik dhe neuromotor të fëmijës, si dhe aftësinë për të identifikuar devijimet nga norma të këtij zhvillimi.</li></ul>
<b>Objektivat e lëndës</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>▪ Njohja me tërësinë e normave morale dhe pikëpamjeve juridike që rregullojnë mirë ushtrimin e profesionit të infermierit.</li><li>▪ Njohja mbi teoritë psikologjike, të cilat studiojnë proceset kognitive dhe sjelljen e njeriut.</li><li>▪ Njohja me psikologjinë klinike.</li><li>▪ Njohja me ecurinë dhe ndjekjen e fëmijës nga momenti i konceptimit dhe deri në moshën e adultit.</li></ul>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

<b>Rezultatet e pritshme</b>	<p>Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>☞ Të kenë njohuri mbi normat morale dhe juridike që rregullojnë mbarëvajtjen e profesionit të infermierit.</li><li>☞ Të kenë njohuri mbi teoritë psikologjike dhe diagnozat infermiore bazë në rastet e problemeve psikologjike të pacientëve të hospitalizuar.</li><li>☞ Të kenë njohuri në vlerësimin e zhvillimit fizik dhe neuromotor normal të fëmijës.</li><li>☞ Të ketë aftësi në për identifikuar devijimet nga norma të zhvillimit fizik dhe neuromotor të fëmijës.</li></ul>
------------------------------	---

**KONCEPTET THEMELORE**

- Etika dhe deontologjia infermiore, si bazat për rregullimin e mbarëvajtjes së ushtrimit të profesionit të infermierit.
- Legjislacionin shqiptar për problemet e shëndetit dhe të shërbimit shëndetësor.
- Teoritë psikologjike të zhvillimit dhe diagnozat infermiore bazë në rastet e problemeve psikologjike të pacientëve të hospitalizuar.
- Zhvillimi fizik, psikologjik dhe neuromotor normal i fëmijës.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	<b>Tema 1</b> - Njohja me programin dhe kërkesat e lëndës. Hyrje në Etikë dhe Deontologji infermiore. Objekti i studimit të etikës dhe deontologjisë infermiore. <i>Njohja me përkufizimin e etikës infermiore, me deontologjinë si disiplinë mbi detyrimin mjekësor, njohja me bioetikën.</i>	<i>fq.3 – 4</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 2</b> - Historiku i Etikës dhe Deontologjisë. <i>Etapat e zhvillimit të kësaj discipline, parimet e Hipokratit.</i>	<i>fq.4 – 7</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 3</b> - Të drejtat e pacientit. <i>Njohja me të drejtat kryesore të pacientit, e drejta për informim, e drejta për të përfituar kujdes shëndetësor, e drejta për të vendosur për ndërhyrjet në trupin e vet, e drejta për privatësi dhe ruajtje të sekretit.</i>	<i>fq.8 – 10</i>	Leksion 1 orë
	<b>Seminar 1:</b> Etika dhe deontologjia infermiore, historiku i tyre dhe respektimi i të drejtave të pacientit.		Seminar 1 orë
II.	<b>Tema 4</b> - Urdhri i Infermierit dhe Kodi Deontologjik Mjekësor në Shqipëri. <i>Njohja me detyrimet e etikës profesionale, me raportet infermier-pacient, me raportet me institucionet dhe pakti infermier-pacient.</i>	<i>fq. 11-19</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 5</b> - Përgjegjësia ligjore në infermieristikë. Qëndrimi i Kodit tonë Deontologjik dhe Penal. <i>Njohja me pakujdesinë mjekësore, shkelja mjekësore, krimi mjekësor dhe kundra vajtja penale.</i>	<i>fq. 39-40</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 6</b> - Kodi i Etikës dhe Deontologjisë së Infermierit në Shqipëri. Legjislacioni shqiptar në fushën e mjekësisë. <i>Ligje të ndryshme mbi kujdesin shëndetësor, si ligji për ndërprerjen e shtatzënisë, ligji për parandalimin e sëmundjeve ngjyëse, ligji për</i>	<i>Fq 43-63.</i>	Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<i>transfuzionet e gjakut.</i> <b>Seminar 2:</b> Detyrimet e etikës infermiere në praktikën profesionale.Ligjet mbi kujdesin shëndetësor.		Seminar 1 orë
III.	<b>Tema 7</b> - Kodi i Etikës dhe Deontologjisë së Infermierit në Shqipëri. Legjislacioni shqiptar në fushën e mjekësisë.(vazhdim) <i>Të njihemi me parimet kryesore të etikës,me detyrat e infermierit ndaj të sëmurit dhe me kushtet e ushtrimit të profesionit.Ligji për shëndetin mendor,ligji për transplantin e organeve,ligji për ushqyerjen me gji,ligji për shëndetin riprodhues,për autopsitë.</i> <b>Tema 8</b> - Dimensioni human i shërbimit infermieror. <i>Njohja me paarimet bazë të humanizmit që duhet të tregojë infermieri gjate praktikës profesionale.</i> <b>Tema 9</b> - Kuptimi etik dhe juridik i sekretit mjekësor. <i>Njohja me rëndësinë e ruajtjes së sekretit mjekësor dhe situatat në të cilat ndodhemi nga pikëpamja etike përsa i përket sekretit mjekësor.</i> <b>Seminar 3:</b> Përgjegjësia ligjore në infermieristikë dhe qëndrimi i Kodit tonë Deontologjik dhe Penal dhe ligjet e tjera mbi kujdesin shëndetësor.Dimensioni human i i shërbimit infermieror.	<i>fq.23-33, 60-86</i>  <i>Fq.101-102</i>  <i>Fq103-105</i>	Leksion 1 orë  Leksion 1 orë  Leksion 1 orë  Seminar 1 orë
IV.	<b>Tema 10 - 11</b> - Marrja e vendimit jetik në shërbimin mjekësor.Ndërprerja e terapisë apo mosfillimi i saj. <i>Njohja me çështjet konceptuale bazë mbi vendimin mjekësor,tre modelet e vendim-marrjes në kujdesin shëndetësor.</i> <b>Tema 12</b> - Komunikimi infermier-pacient. <i>Njohja me rëndësinë e logoteknikës klinike dhe shmangia e gabimeve në komunikimin me pacientin.</i> <b>Seminar 4:</b> Kuptimi etik dhe juridik i sekretit mjekësor.Marrja e vendimit jetik në shërbimin mjekësor. Komunikimi infermier-pacient.	<i>Fq.106-108</i>	Leksion 2 orë  Leksion 1 orë  Seminar 1 orë
V.	<b>Kapitulli II : Psikologjia mjekësore</b> <b>Tema 13</b> - Hyrje në psikologji.Objekti i studimit të psikologjisë në përgjithësi dhe psikologjisë mjekësore në veçanti. <i>Njohja me psikologjinë si shkencë e sjelljes dhe kognicionit.</i> <b>Tema 14</b> - Historiku i psikologjisë. <i>Zhvillimi i psikologjisë si shkencë.Njohja me drejtimet aktuale të studimit të Psikologjisë.</i> <b>Tema 15</b> - Të mësuarit <i>Të mësuarit si një ndryshim relativisht i përhershëm në sjelljen dhe aftësinë e individit për të manifestuar një sjellje të caktuar,që ndodh si rezultat i përvojës.</i> <b>Seminar 5:</b> Njohuritë mbi psikologjinë mjekësore.Të mësuarit.	<i>fq 11-12</i>  <i>fq12-16</i>  <i>fq.17-25</i>	Leksion 1 orë  Leksion 1 orë  Leksion 1 orë  Seminar 1 orë
VI.	<b>Tema 16</b> - Kujtesa. <i>Ndryshimi midis të mësuarit dhe kujtesës.Proceset e kujtesës,si depozitohet informacioni dhe llojet e kujtesës.</i> <b>Tema 17</b> - Inteligjenca. <i>Njohja me formimin e konceptit ose të mësuarit e konceptit.Teoritë e</i>	<i>fq 26-34</i>  <i>fq 46-52</i>	Leksion 1 orë  Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>inteligjencës dhe matja e saj.</i> <b>Tema 18</b> - Personaliteti dhe vlerësimi i tij. <i>Personaliteti si shumë totale e të gjitha gjërave që përbëjnë një person:veprimet e tij,mendimet e ndjenjat. Si vlerësohet personaliteti dhe teoritë rreth tij.</i></p> <p><b>Seminar 6:</b> Kujtesa dhe inteligjenca.Vlerësimi i personaliteteve të ndryshme,normal dhe patologjik.</p>	<p><i>fq 59-73</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p>
VII.	<p><b>Tema 19</b> - Stresi dhe përshtatja.(pjesa e parë) <i>Në pjesën e parë,bëhet njohja me përkufizimin e stresit,me shkaqet madhorë psikologjike të stresit.Njohja me llojet e konfliktit,si një dukuri me dy tendenca të kundërta.</i></p> <p><b>Tema 20</b> - Stresi dhe përshtatja.(pjesa e dytë) <i>Në pjesën e dytë,njihemi me përshtatjen si mënyrën e reagimit ndaj kërkesave të stresit në jetën tonë.Njohja me reagimet kryesore ndaj stresit.</i></p> <p><b>Tema 21</b> - Stresi dhe përshtatja.(pjesa e tretë) <i>Në pjesën e tretë,njihemi me efektet psikologjike të stresit në gjendjen shëndetësore dhe me mekanizmat mbrojtës,si teknika psikologjike me anë të të cilave përpiqemi të mbrojmë veten nga ankthi dhe stresi.</i></p> <p><b>Seminar 7:</b> Njohja dhe përdorimi i mekanizmave të ndryshëm mbrojtës ndaj stresit.</p>	<p><i>fq. 74-76</i></p> <p><i>fq 77-85</i></p> <p><i>fq 85-94</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p>
VIII.	<p><b>Tema 22</b> - Gjendja anksioze. <i>Një situatë kjo e shoqëruar me ndjenja të diskomfortit dhe aktivizim të sistemit nervor autonom,në përgjigje të një kërcënimi të vakët dhe jospecifik.Ku bazohet diagnostikimi dhe kujdesi infermior në gjendjen anksioze.</i></p> <p><b>Tema 23</b> - Frika <i>Njohja me karakteristikat madhore dhe minore përcaktuese të frikës.Ku bazohet kujdesi infermior në këtë situatë.</i></p> <p><b>Tema 24</b> - Humbja e shpresës. <i>Një gjendje emocionale,subjektive,ku individi nuk shikon alternativa në zgjidhjen e problemeve.Kujdesi infermior ka shumë rëndësi në përballimin e kësaj situatë.</i></p> <p><b>Seminar 8:</b> Komunikimi me pacientët para operacionit.Diagnostikimi dhe trajtimi i gjendjes së ankthit,frikës dhe humbjes së shpresës.</p>	<p><i>fq 95-114.</i></p> <p><i>fq 115-125</i></p> <p><i>fq 138-153</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p>
IX.	<p><b>Tema 25</b> - Refuzimi i terapisë. <i>Njohja me faktorët etiologjikë,kontribues dhe riskues.Rëndësia e kujdesit infermior në këtë situatë dhe rezultatet e pritshme.</i></p> <p><b>Tema 26</b> - Çrregullimi i konceptit mbi vetveten. <i>Gjendje gjatë së cilës individi përjeton një situatë negative ndryshimi,në mënyrën se si e ndjen,mendon apo shikon vetveten.Infermieri duhet të njihet me strategjinë e veprimit në këtë rast.</i></p> <p><b>Tema 27</b> - Të ndjerit i pafuqishëm –reagimi psikologjik normal gjatë hospitalizimit. <i>Një gjendje gjatë së cilës individi percepton humbjen e kontrollit individual</i></p>	<p><i>fq 154-165</i></p> <p><i>fq 175-198</i></p> <p><i>fq 166-174</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>mbi situata apo ngjarje të caktuara.</i></p> <p><b>Seminar 9:</b> Diagnostikimi dhe trajtimi i çrregullimit të konceptit mbi vetveten. Të ndjerit i pafuqishëm –reagimi psikologjik normal gjatë hospitalizimit.</p>		Seminar 1 orë
X.	<p><b>Tema 28</b> - Stadi terminal i sëmundjes-problemet psikologjike. <i>Kujdesi dhe menaxhimi i pacientit në prag të vdekjes dhe parimet që ndjek infermieri.</i></p> <p><b>Tema 29</b> - Konsumimi psiko-emocional i personelit mjekësor. <i>Kjo dukuri lidhet me një nga pasojat më të rëndësishme të ngarkesës psikologjike të personelit mjekësor.Njohja me faktorët kontribues në shfaqjen e kësaj dukurie.</i></p> <p><b>Tema 30</b> - Problemet e familjes së të sëmurit. <i>Roli i infermierit me ndërhyren e tij në minimizimin e ankthit dhe pasojat e tij,në një familje që duhet të përballlet me diagnozën dhe komplikacionet e saj.</i></p>	<p><i>fq 217-224</i></p> <p><i>fq 265-268</i></p> <p><i>fq225-237</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>
	<p><b>Seminar 10:</b> Konsumimi psiko-emocional i personelit mjekësor.Pacientët në stadin terminal të sëmundjes.</p>		Seminar 1 orë
XI.	<p><b>Kapitulli III: Pediatria e zhvillimit</b></p> <p><b>Tema 31</b> - Objekti i studimit të pediatriisë së zhvillimit. <i>Pediatria e zhvillimit,si një degë e pediatriisë që studion mirë-rritjen dhe mirë-zhvillimin e fëmijës.</i></p> <p><b>Tema 32</b> - Zhvillimi fizik dhe faktorët ndikues.Endokrinologjia e rritjes dhe zhvillimit. <i>Zhvillimi fizik si një rezultante e procesit të rritjes dhe pjekurisë.Faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që ndërhyjnë në zhvillimin fizik.</i></p>	<p><i>fq 104-105</i></p> <p><i>fq 110-112</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>
	<p><b>Tema 33</b> - Kurbat e rritjes dhe indeksi i pjekurisë. <i>Parametrat që vlerësojmë në monitorimin e rritjes së fëmijës dhe kurbat më të përdorshme të rritjes mbeten ato të shprehura në deviacione standarde.Indeksi i pjekurisë i matur me anë të moshës kockore.</i></p> <p><b>Seminar 11</b> - Objekti i studimit të pediatriisë së zhvillimit.Rritja dhe zhvillimi i fëmijës. Ushtrime mbi vlerësimin fizik të fëmijës me anë të kurbbave të rritjes.</p>	<p><i>fq 106-109</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p>
XII.	<p><b>Tema 34</b> - Stadet e zhvillimit të fëmijës. <i>Rëndësia që ka studimi i këtyre stadeve,si pika përmbushëse madhore në zhvillimin e aftësive motore,sociale,konjitive dhe gjuhësore.</i></p> <p><b>Tema 35</b> - Testi standart i zhvillimit Denver II dhe Age &amp; Stage Questionaries. <i>Njohja me këtë metodë si një mjet depistues,i hartuar për fëmijët 1-66 muajsh,të cilët mund të kenë nevojë për ndërhyrje apo shërbim të edukimit special në fëmijërinë e hershmë.</i></p> <p><b>Tema 36</b> - Sektorët e zhvillimit psikomotor dhe zhvillimet atipike. <i>Përdorimi i sektorëve të zhvillimit në vlerësimin si të gjendjes aktuale,ashtu edhe ecurinë në vazhdimësi të aftësive dhe sjelljeve të fëmijës.</i></p>	<p><i>fq 113-114</i></p> <p><i>fq 121-122</i></p> <p><i>fq 115-117</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<b>Seminar 13:</b> Praktikimi i zhvillimit psiko-motor të fëmijës me anë të testit Denver II dhe Age & Stage Questionarie.		Seminar 1 orë
XIII.	<b>Tema 37</b> - Ekzaminimi psikomotor i fëmijës normal. <i>Njohja me aspekte të motorikës dhe pozicionimit të fëmijës dhe njohja me reflekset arkaike.</i>	<i>fq 134-136</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 38</b> - Zhvillimi psikologjik i fëmijës. <i>Teoritë kryesore që tentojnë të shpjegojnë psikologjinë e fëmijës.</i> <b>Tema 39</b> - Ndjekja ambulatorë e fëmijës. <i>Vizitat e rekomanduara dhe të detyruara gjatë ndjekjes së një fëmije normal.</i>	<i>fq 134-136</i> <i>fq 157-159</i>	Leksion 1 orë Leksion 1 orë
	<b>Seminar 14:</b> Praktikimi mbi njohjen e plotë dhe kryerjen e një ekzaminimi të plotë psikomotor të një fëmije normal. Njohja me ndjekjen ambulatorë të fëmijës (fletorja e shëndetit).		Seminar 1 orë
XIV.	<b>Tema 40</b> - Adoleshenca dhe puberteti. <i>Ndryshimet që ndodhin gjatë pubertetit në zhvillimin fizik, në personalitet dhe në zhvillimin social.</i>	<i>Fq150-152</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 41</b> - Ushqyerja natyrale. <i>Sekretimi i qumështit dhe ndryshimi i përbërjes së qumështit të gjirit me kalimin e ditëve.</i>	<i>Fq 160-163</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 42</b> - Përparësitë e qumështit të gjirit për fëmijën. <i>Si ndikon ushqyerja me gji pozitivisht në disa drejtime të shëndetit të fëmijës</i>	<i>Fq 164-168</i>	Leksion 1 orë
	<b>Seminar 14:</b> Njohja me vlerat e ushqyerjes me gji si për fëmijën dhe për nënën.		Seminar 1 orë
XV.	<b>Tema 43</b> - Ushqyerja artificiale. <i>Qëllimet e ushqyerjes artificiale dhe disa nga rregullat që duhen zbatuar në fillimin e saj.</i>	<i>fq 181-186</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 44</b> - Kodi i marketingut mbi zëvendësuesit e qumështit të gjirit. <i>Qëllimi i kodit, informimi dhe edukimi i publikut, nënës dhe sistemit shëndetësor. Zbatimi dhe monitorimi i kodit.</i>	<i>fq 178-180</i>	Leksion 1 orë
	<b>Tema 45</b> - Kequshqyerja dhe obeziteti. <i>Klasifikimi i kequshqyerjes, shenjat klinike, diagnostikimi dhe mjekimi. Etiologjia e obezitetit, pasojat e tij dhe parandalimi e trajtimi.</i>	<i>fq 189-197</i>	Leksion 1 orë
	<b>Seminar 15:</b> Ushqyerja natyrale dhe artificiale. Kequshqyerja dhe obeziteti tek fëmijët		Seminar 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

**FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE**

<b>FREKUENTIMI:</b>							
<p>Kyçi i një edukimi të suksesshem është pjesëmarrja dhe përgatitja. Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e seminarit janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrëveshje me pedagogun.</p> <p>Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studenti humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.</p>							
<b>KONTROLLI I VAZHUESHËM</b>	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>	
	Provimi I	Java 7/8	Kapitulli I = Etika dhe deontologjia infermiere Leksion nr 1,2,3 dhe 4.	30 pikë	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz	
	Provimi përfundimtar	Fundi i semestrit	Kapitulli II = Psikologjia mjekësore Kapitulli III=Zhvillimi pediatrik	60 pikë	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz	
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Gjate semestrit	-	10 pikë	Pyetje me gojë/shkrim	-	
	*Vlerësim i vazhduar - Do të realizohet prej pedagogut të seminarit për gjatë gjithë semestrit. Studenti vlerësohet mbi aftësinë për të përpunuar materialin e dhënë, krijimin e lidhjeve logjike rreth temave, interesin për punë kërkimore rreth atij materiali dhe aftësinë për të krijuar lidhje mes aspektit teorik dhe praktik të lëndës.						
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare është si më poshtë:						
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë	
5	6	7	8	9	10		

**LITERATURA**

<b>Literatura bazë</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. A.Saliaj .<b>Etika dhe Deontologjia mjekësore.</b> 2010</li> <li>2. A.Saliaj .<b>Psikologjia mjekësore.</b> 2009</li> <li>3. A.Saliaj .<b>Pediatria.</b>2015 (Fakulteti i Shëndetit Publik-UV)</li> </ol>
<b>Literatura e rekomanduar</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>o Legjislacioni <a href="http://www.msh.gov.al">www.msh.gov.al</a></li> <li>o Clinical ethics in pediatrics : a case-based textbook / [edited by] Douglas S. Diekema, Mark R. Mercurio, Mary B. Adam. © Cambridge University Press 2011, ISBN 978-0-521-17361-2</li> <li>o "Nursing Ethics, 5th Edition" an Thompson Kath Melia Kenneth Boyd Dorothy HorsburgheBook ISBN: 9780702059988, 2006</li> </ul>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

**VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS**

<b>Dispozita:</b>	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjate procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.
<b>Vonesat</b>	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
<b>Sjellja profesionale e studentit</b>	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijance nga këto rregulla, do të ketë penaltete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit dhe të Fakultetit të Shëndetit Publik.
<b>Integriteti akademik dhe e drejta e autorit</b>	Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale dhe në pamundësi, të ë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzjerjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.